Në vijim të shkresës suaj datë 28.09.2026, të protokolluar me tonën me nr. 2390/18 prot., datë 30.09.2026, me lëndë: *"Kërkesë për zbatim vendimi Gjyqësor (të formës së prerë), në lidhje me shkresën nr. 2390/16 prot., datë 23.09.2026, si dhe të shkresës nr. 2390/15 prot., datë 23.09.2026 të Departamentit të Administratës Publike"*, ju bëjmë me dije se:

Në kuadër të detyrimit kushtetues dhe ligjor për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, strukturat përgjegjëse në Departamentin e Administratës Publike (DAP), kanë shqyrtuar mundësinë e sistemimit tuaj në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, në zbatim të vendimit nr. 1302 (1302) datë 08.05.2026, të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 1362 (80-2022-1387) datë 28.04.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë, ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar dhe urdhrit nr. 5151 datë 28.10.2015 *"Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil"*.

Në vijim të shqyrtimit të kryer, DAP ka nxjerrë aktin nr. 2390/15 prot., datë 23.09.2026, për emërimin e z.x.y, në pozicionin *"Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (klasa e pagës IV-2)."*

Me vendimin nr. 1302(1302) datë 08.05.2026 të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 1362 (1387) datë 28.04.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë, është vendosur ndër të tjera:

"5. Detyrimin e palës së paditur, Departamenti i Administratës Publike, të sistemojë paditësin x.y në një pozicion pune të së njëjtës kategori në shërbimin civil dhe me të njëjtën page..."

Për sa i përket pretendimit tuaj për paligjshmërinë e aktit të emërimit nr. 2390/15 prot., datë 23.09.2026, vlerësojmë që ky pretendim është i pabazuar pasi nuk jemi në asnjë prej rasteve të paligjshmërisë të parashikuara nga neni 109 i Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se:

"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:
a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;
d) është në kundërshtim me ligjin material;
dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo
e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit."

Për sa i përket kompetencës së organit publik që ka nxjerrë aktin sqarojmë se, akti i emërimit nr. 2390/15 prot., datë 23.09.2026, është nxjerrë nga organi kompetent, DAP sipas parashikimeve të nenit 7 dhe 66/1 të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar dhe ligjit nr. 90/2012 *"Për organizimin dhe funksionimine administratës shtetërore"*, të ndryshuar.

Në bazë të pikës 1, të nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar parashikohet se vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse, që në rastin e institucioneve të administratës shtetërore është DAP-i.

Lidhur me procedurën e ndjekur sqarojmë se, në zbatim të vendimit nr. 1302(1302) datë 08.05.2026 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nenit 66/1 të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, DAP, në cilësinë e njësisë përgjegjëse ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit tuaj në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, sipas procedurës së parashikuar në urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015.

Nga verifikimet e kryera në momentin e zhvillimit të procedurës administrative për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit, ka rezultuar se pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, ku keni ushtruar detyrën përpara transferimit për shkak të ristrukturimit, nuk ka pasur vende të lira ku plotësoni kriteret e përgjithshme dhe të posaçme. Në këto kushte, referuar shkronjës "a", të pikës 2, të kreut V, të urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, DAP ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit tuaj në një institucion tjetër, në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, të së njëjtës kategori.

Në vijim të shqyrtimit të kryer nga DAP, mbi pozicionet e lira në shërbimin civil dhe vlerësimit të kritereve të pozicionit të punës, në përputhje me arsimin dhe përvojën tuaj profesionale, me shkresën nr. 2390/5 prot., datë 01.09.2026 ju është propozuar pozicioni *"Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (klasa e pagës IV-2)."*

Pozicioni i propozuar nga DAP, është në përputhje me detyrimin e përcaktuar në vendimin e gjyqësor së formës së prerë, pasi i përket të njëjtës kategori në shërbimin civil dhe të njëjtës klasë page që keni pasur përpara transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Theksojmë se në bazë të pikës 4, të kreut V, të urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, DAP kërkon pëlqimin e gjyqfituesit vetëm në rastin kur i propozon mundësinë e sistemimit në një pozicion më të ulët të shërbimit civil.

Në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe legjislacionit të sipërcituar DAP, ka vijuar me nxjerrjen e aktit të emërimit nr. 2390/15 prot., datë 23.09.2026. Ky akt ju është përcjellë me shkresën nr. 2390/16 prot., datë 23.09.2026, ku ju është përcjellë edhe një kopje e formularit të deklarimit sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 138/2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, të ndryshuar.

Për sa i takon formës dhe elementëve të aktit, sqarojmë se akti i emërimit nr. 2390/15 prot., datë 23.09.2026, përmban të gjithë elementet formalë të një akti administrativ, në përputhje me përcaktimet e nenit 99, të Kodit të Procedurave Administrative.

Akti është nxjerrë në përputhje me nenin 11, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se:

"Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:
a) është i parashikuar me ligj;
b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;

c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi;dhe;
ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustifikuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme."

Akti i emërimit është nxjerrë nga DAP, në ushtrim të ligjshëm të diskrecionit, pasi nxjerrja e tij është e parashikuar në nenin 66/1, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, nuk ka tejkaluar kufijtë e ligjit, por është brenda hapësirës që i është dhënë në këtë ligj në zbatim të detyrimit kushtetues dhe ligjor. Nxjerrja e aktit është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni, që është sistemimi i gjyqfituesit në një pozicion të rregullt të shërbimit civil si dhe nuk përbën një shmangie të pajustifikuar nga rastet e njëjta apo të ngjashme që lidhen me sistemimin e gjyqfituesve.

Akti i emërimit është nxjerrë nga DAP në përputhje me nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se:

"1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:
"a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;
b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe
c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë".

Pra, akti i emërimit nr. 2390/15 prot., datë 23.09.2026, është nxjerrë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke mbajtur në konsideratë se ka qenë i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj dhe është arritur me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës, pasi pozicioni i propozuar i përket të njëjtës kategori në shërbimin civil dhe të njëjtës klasë page që ka pasur përpara transferimit.

Në të njëjtën linjë është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, që në vendimin nr. 47/2014, paragrafi 35, shprehet se:

"I takon palës debitore të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së palës kreditore. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë."

Gjithashtu bazuar në vendimin nr. 16/2014 të Gjykatës Kushtetuese citohet se: *"Debitori në këtë rast duhet të mbajë parasysh jo vetëm detyrimin që ka ndaj kreditorit por edhe interesin publik në administrimin e mirë të buxhetit të shtetit për të mos i shkaktuar atij dëme financiare. Në këtë kuptim, një realizim i plotë i detyrimit është jo vetëm në favor të kreditorit për të realizuar të*

drejtën e tij të fituar nga një vendim gjyqësor, por i shërben edhe administrimit sa më të mirë të të ardhurave të taksapaguesve."

Në konkluzion të sa më sipër, ju bëjmë me dije se, DAP ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil.

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 29, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.